

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Constitutional Articles: E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm

Constitutional Paragraph: Neni 31.3

3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj

Instrumentet ndërkombëtare

Nenet

Neni 14 para 1.

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

1. Të gjithë janë të barabartë përpara gjykatave dhe organeve të drejtësisë. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të trajtohet me paanshësi dhe publikisht nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e ngritur sipas ligjit, që do të vendosë qoftë për përcaktimin e çdo akuze të karakterit penal që drejtohet kundër tij, qoftë për konfliktet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij në fushën civile. Shtypi dhe publiku mund të largohen gjatë gjithë procesit ose të një pjese të tij, qoftë kur e kërkon interesi i sjelljes së moralshme, i rendit publik ose i sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, ose kur e kërkon interesi i jetës private të palëve, qoftë edhe kur gjykata e quan krejtësisht të domosdoshme në qoftë se, për disa rrethana të veçanta të çështjes, publiciteti mund të dëmtojë interesat e drejtësisë; megjithatë çdo gjykim i dhënë në çështjen penale ose civile do të jetë publik, me përjashtim të rasteve kur interesi i të miturve kërkon ndryshe ose në qoftë se procesi ka të bëjë me mosmarrëveshje martesore ose me kujdestarinë e familjeve.

Neni 6 para. 1

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojë interesat e drejtësisë.

Ligjet

Nenet

Neni 288

Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor

KODI NR. 08/L-032 I
PROCEDURËS PENALE
KODI NR. 08/L-032 I
PROCEDURËS PENALE

1. Shqyrtimi gjyqësor është publik me përjashtim të rasteve kur me këtë Kod parashihet ndryshe.
2. Personat e pranishëm në shqyrtim gjyqësor nuk mund të mbajnë armë ose mjete të rrezikshme, me përjashtim të zyrtarëve të shërbimit korrektues dhe zyrtarëve të policisë që ruajnë të akuzuarin, të cilët mund të jenë të armatosur.

Neni 3

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR
PROCEDURËN
KONTESTIMORE
LIGJI Nr. 03/L-006 PËR
PROCEDURËN
KONTESTIMORE

4.1 Gjykata vendos për kërkesëpadinë pas shqyrtimit të çështjes juridike në seancë të drejtpërdrejtë dhe publike.

4.2 Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj.

4.3 Gjykata e shqyrton çështjen në seancë jopublike vetëm në rastet e përcaktuara me ligj

Neni 444

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR
PROCEDURËN
KONTESTIMORE
LIGJI Nr. 03/L-006 PËR
PROCEDURËN
KONTESTIMORE

444.1 Shqyrtimi kryesor i çështjes bëhet publikisht. 444.2 Në vendin ku mbahet seanca për shqyrtimin kryesor mund të jenë të pranishëm vetëm personat e moshës madhorë. 444.3 Personat që janë të pranishëm në seancë nuk guxojnë të mbajnë armë apo mjete të rrezikshme.

444.4 Dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni nuk kanë të bëjnë me rojtaret e personave që marrin pjesë në procesin gjyqësor.

Neni 445

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR
PROCEDURËN
KONTESTIMORE
LIGJI Nr. 03/L-006 PËR
PROCEDURËN
KONTESTIMORE

Gjykata lejon, me vendim të arsyetuar, që gjykimi i çështjes tërësisht apo pjesërisht, të bëhet në seancë me dyer të mbyllura/jo publike/, vetëm kur:

- a) është e nevojshme të ruhet një sekret zyrtar dhe rendi publik;
- b) përmendën sekrete tregtare, apo shpikjesh, nga publikimi i të cilave do të cenoheshin interesa që mbrohen me ligj; c) përmenden rrethana nga jeta intime private e palëve dhe e pjesëmarrësve të tjerë në proces.

Neni 446

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR
PROCEDURËN
KONTESTIMORE
LIGJI Nr. 03/L-006 PËR
PROCEDURËN
KONTESTIMORE

446.1 Në gjykimin e çështjeve me dyer të mbyllura lejohen të qëndrojnë në sallën e gjyqit vetëm palët, përfaqësuesit e tyre ligjor ose me prokurë dhe ndërhyrësit. Me lejen e gjykatës mund të qëndrojnë në sallën e gjyqit personat zyrtar të caktuar, punëtorët publik dhe shkencor, po që se një gjë e tillë është me interes për shërbimin e tyre, përkatësisht për veprimtarinë e tyre publike apo shkencore.

446.2 Gjyqtari do ti paralajmërojë personat që janë të pranishëm në seancë nga e cila është përjashtuar publiku, se e kanë për detyrë ta ruajnë si fshehtësi çdo gjë që mësojnë në seancën e këtillë, si dhe për pasojat e zbulimit të fshehtësisë.

Neni 447

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR
PROCEDURËN
KONTESTIMORE
LIGJI Nr. 03/L-006 PËR
PROCEDURËN
KONTESTIMORE

447.1 Aktvendimin për zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura gjykata duhet ta arsyetojë dhe ta shpallë publikisht.

447.2 Kundër aktvendimit me të cilin vendoset zhvillimi i gjykimit me dyer të mbyllura nuk lejohet ankim i veçantë.

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR
PROCEDURËN
KONTESTIMORE
LIGJI Nr. 03/L-006 PËR
PROCEDURËN
KONTESTIMORE

Neni 448

Dispozitat për zhvillimin e gjykimit me dyer të hapura në mënyrë adekuate do të zbatohen për seancën përgatitore dhe atë përpara gjykatës së porositur.

decisionTitle*

decisionDescription*

15924/05 | Aktgjykim | 01/03/2011

Welke dhe Bialek
kundër Polonisë

Gjykata kërkesën e shpalljes publike të aktgjykimeve e zbaton me një shkallë fleksibiliteti. Kështu, Gjykata gjen se përkundër formulimit që duket se sugjeron që leximi i aktgjykimit në gjykatë të behet në mënyrë të hapur, edhe forma të tjera të komunikimit të një vendimi publik mund të jenë në përputhje me nenin 6 § 1.

Në rastin në fjalë, GjEDNJ ka gjetur se vendimet e Gjykatës së Instancës së Parë dhe Gjykatës së Apelit ishin të justifikuar në dhënien e një vendimi publik. GjEDNJ vuri në dukje se në një situatë të tillë dhe në përputhje me nenin 364 § 2 të KPP-së, deklarimi me gojë i arsyeve për aktgjykimin e tyre gjithashtu mund të bëhet me kamerë, e cila është në përputhje me nenin 6 par. 1 të KEDNJ.

decisionTitle*

decisionDescription*

7819/77 7878/77 | AktGgjykim | 28/06/1984

Campbell dhe Fell
k. Mbretërisë së
bashkuar

Duke konstatuar shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së në këtë rast, pasi vendimi nuk ishte dhënë publikisht, GjEDNJ deklaroi se nuk ndihet e detyruar të miratojë një interpretim literal të fjalëve "shpallur publikisht": në secilin rast forma e publikimit që jepet 'gjykimit' sipas ligjit të brendshëm të shtetit të paditur duhet të vlerësohet në dritën e veçorive të veçanta të procedurës në fjalë dhe duke iu referuar objektit të ndjekur nga Neni 6 në këtë kontekst, përkatësisht për të siguruar shqyrtimin e gjyqësori nga publiku me qëllim ruajtjen e të drejtës për një gjykim të drejtë.